

VENDIM
Nr. 671, datë 3.10.2012

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2012, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR ORGANIZIMIN E CEREMONIVE ZYRTARE PËR EKSPOZIMIN E “MESHARIT” TË GJON BUZUKUT, NË MJEDISËT E BIBLIOTEKËS KOMBËTARE, DHE PËR EKSPOZIMIN E ARMËVE TË SKËNDERBEUT, NË MJEDISËT E MUZEUT HISTORIK KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e miratuar për vitin 2012, në zërin “Projekte”, artikulli 604, t’i shtohet fondi prej 1 003 456 (një milion e tri mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekësh, për organizimin e ceremonive zyrtare për ekspozimin e “Mesharit” të Gjon Buzukut, në mjediset e Bibliotekës Kombëtare, dhe fondi prej 1 280 000 (një milion e dyqind e tetëdhjetë mijë) lekësh, për ekspozimin e armëve të Skënderbeut në mjediset e Muzeut Historik Kombëtar, sipas preventivave bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha